

## NJOFTIM

### Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kërkon të marrë me qira ambiente për zyra

Në bazë të Urdhërit me Nr. 2622/3 Prot. datë 20.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për marrje me qira ambiente zyrash për akomodimin e punonjësve të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për disa Drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shpallim njoftimin:

Ambientet që do të merren me qira nga ana e DPT-së duhet që të plotësojnë kërkesat e mëposhtme;

- të ketë një sipërfaqe me hapësirë jo më pak se 2800 m<sup>2</sup>, dhe jo më shumë se 3000 m<sup>2</sup>;
- të jetë sa më pranë ambienteve ekzistuese të DPT-së, dhe jo më larg se 3 km në vijë ajrore nga godina kryesore e DPT-së;
- të jetë në pozicion gjeografik sa më funksional për bizneset;
- ambientet e brendshme të jenë “Open Space”, të përshtatshme dhe të ofrojnë funksionalitet/ndarje për të sistemuar 20 -30 poste pune për punonjësit;
- të ketë ndriçim natyral si dhe të garantohet hapja e dritareve për ajrim;
- objekti duhet të jetë i përfunduar me dyer, dritare, i lyer dhe i gatshëm / i lirë për t’u shfrytëzuar nga qiramarrësi;
- objekti/ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, linjë telefonike si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike;
- ambienti i arshivës të garantojë siguri si dhe ajrim ose aspirim;
- objekti duhet të ketë furnizim të rregullt me ujë të pijshëm dhe energji elektrike me matës të dedikuar;
- objekti duhet të ketë shkallë emergjence dhe rampa për persona me aftësi të kufizuar;
- objekti duhet të ketë sistem/pajisje kundra zjarrit;
- ambientet duhet të jenë bosh dhe të lira, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 7 ditëve nga njoftimi për lidhje kontrate;
- ambientet/objekti në total duhet të kenë minimalisht 20 tualete të kompletuara me pajisjet hidrosanitare dhe pajisje;
- vërtetim nga Furnizuesi i Sherbimit Universal dhe Ujësjellës Kanazime Tiranë Sh.a, që subjekti nuk ka detyrime të palikuiduara për objektin;
- vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, se nuk ka proces penal, civil apo administrativ ndaj administratorit / pronarit të këtij objekti;
- aktin administrativ zyrtar që objekti rezulton i rregullt nga ana inxhinierike dhe ndërtimore si dhe akt konstatimin që rezulton i banueshëm nga Institucioni i Ndërtimit;
- objekti të jetë me dokumenta të rregullta ligjore;
- dokument identifikimi i pronarit të objektit (pasaportë ose kartë identiteti).
- afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi;

Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj kundrejt lëshimit të faturës tatimore. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve tatimore do të kryhet nga DPT-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat e tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.

Objekti që do të merret me qira duhet t'i vihet në dispozicion qiramarrësit brenda 7 ditëve nga njoftimi për lidhje kontrate, me opsion shtyrje edhe për vitet e tjera nëse do të jetë e nevojshme.

Shënim: Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në formën e tij ligjore (i njehsuar me origjinalin) dhe i lëshuar brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ofertës.

Ofertat, me kriteret si më sipër, duhet të paraqiten deri në datën 09.06.2022, ora 14.00, në zyrën e protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.